




Komuna e Rahovecit zyrtarisht pranoi raportin nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Komuna e Rahovecit ka pranuar raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2024, me opinion të pamodifikuar, që do të thotë se të gjitha aspektet materiale të financave tona janë në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.



203 studentë dhe 50 nxënës përfitues të bursës komunale

Drejtorja për Arsim dhe kryetari Latifi pritën studentët dhe nxënësit përfitues të bursave komunale. Nënshkruan kontratat për dhënie e bursave me 203 studentë dhe me 50 nxënës. Nga viti 2018 që janë dhënë gjithsej 63 bursa, në vitin 2025 numri i bursistëve ka arritu në 253, risi e të cilës është dhënia e bursave për nxënësit e ShML-ve dhe të IAAP-së



Përrurohet Shtëpia-muze e Bajram Currit në Krushë të Madhe

Jo vetëm një kujtim, por një thirrje që vjen nga historia: të mos harrojmë kurrë ata që luftuan për tokën, gjuhën dhe lirinë tonë! Bajram Curri është simbol i qëndresës, burrërisë dhe idealeve që na udhëheqin edhe sot. Krusha i shton edhe një gur të fortë mozaikut të trashëgimisë sonë kombëtare.



Vihet gurthemeli i kullës simbol të luftës në Retijë

Në nderim të luftës çlirimtare, do të ndërtohet një kullë me gurë, ku do të ruhen vlerat tona kombëtare. Kjo kullë, me tri hyrje, do të simbolizojë tri brigadat dhe do të ketë mjedise e hapësira për ruajtjen e artefakteve të luftës, hapësirë për aktivitete kulturore e përkujtimore dhe do të bëhet pikë referimi për qëndresën e banorëve të kësaj ane.



Në Krushë të Madhe mbahet ceremonia e dhënies së dekoratës «Ukshin Hoti»

Këtë vit, në mesin e emrave të shquar, dekorata «Ukshin Hoti» iu dha shkrimtarit, studiuesit, arkeologut, eruditit, dr. Mikom Zeqo, pas vdekjes. Shkrimet dhe vëmendja e Moikomit për fatin e Ukshin Hotit kanë ndjeshmërinë e thellë për fatin tragjik të një figure madhore të kombit tonë. Ai u kujdes për redaktimin e veprave të Ukshinit dhe më pas e ngriti zërin, kurdo që iu dha mundësia, për lirinë e tij nga burgu serb.



Emri i Abdullah Bugarit do të shndrisë në Qendrën për Arte, Kulturë dhe Inovacion në Rahovec

Pas propozimit të kryetarit që Qendra për Arte, Kulturë dhe Inovacion në Rahovec të mbajë emrin e heroit Abdullah Bugari, Kuvendi Komunal i Rahovecit vendori njëzëri pro këtij propozimi.

Abdullah (Zijajdin) Bugari i takon plejadës së djemve e të burrave të Rahovecit të cilët mbajtën barrën e organizimit shoqëror, politik e ushtarak. Abdullah Bugari u mor me ngjarjet më të rëndësishme politike që u zhvilluan anekënd Anadrinit, duke qenë dhe në ballë të demonstratave në mbështetje të UÇK-së, si dhe kundër terrorit shtetëror serb në Prekaz të Drenicës. Ishte një ndër prijësit e betejës për Rahovecin, në korrik të vitit 1998, në cilësinë e komandantit të kompanisë.

Po ashtu, përveç anës politike, ishte njeri i kulturës dhe artit, i cili shquhej me mjeshtërinë për imitim dhe interpretim, nga e mori dhe nofkën “Humoristi”.

